

MESILA DODA



Datëlindja: 16.2.1971

Vendlindja: Kukës

E-mail: Mesila.Doda@parlament.al

Jetëshkrimi:

Ka përfunduar studimet në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në vitin 1991. Pas tyre, në vitin 1995 ka përfunduar studimet në Fakultetin e Filozofisë, universiteti “*Pontific Urbaniana*” Vatikan. Në periudhën 1998-1999 ka kryer specializimin për filozofi teorike pranë Universitetit Urbaniana. Në periudhën 2006-2008 ka përfunduar studimet MA Filozofi e PU Urbaniana.

Ka eksperiencë në punë në sektorin publik dhe privat. Në sektorin publik që prej vitit 1997 ka mbajtur pozicione të ndryshme, si: shefe kabineti pranë Ministrisë së Drejtësisë, analiste shtypi pranë Këshillit të Ministrave, zëdhënëse shtypi në Këshillin e Ministrave, konsulente për mediet pranë Ambasadës Italiane në Tiranë, kryetare e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Në sektorin privat ka punuar si drejtuese e emisionit social “Në shtëpinë tonë” në Tv Koha, opinioniste në shtypin e shkruar me editoriale sociale e politike në gazeta “Koha Jonë”, “Expres”, “Standard”.

Në periudhën 2009 – 2017 ka qenë deputete e Kuvendit të Shqipërisë.